

URDHËR
Nr. 1420, datë 22.8.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”, e ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin z. Andi Proko, drejtor i Njesisë së Hartografisë dhe Regjistrisë, kompetencën për të sigluar shpërndarjen e korrespondencës shkresore të administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë të njësive/drejtorive/sektorëve.

2. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Njesisë së Hartografisë dhe Regjistrisë, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29 , pika 2, germa “ç” e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

3. Ngarkohet drejtori i Njesisë së Hartografisë dhe Regjistrisë dhe Sektori i Arkivës dhe Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli